



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:920258  
Datë: 20.11.2020  
Numri i dokumentit: 01287898

**Ae.nr.337/2019**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qërim Ademaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit NNP [“A...”], me seli në fshatin ..., Komuna e Vitisë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [V.M], avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve [“K...”] me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [V.R], për shkak të kompensimit të dëmit dhe fitimit të humbur, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.Ek.nr.496/2018, të datës 02.09.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.11.2020, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET**, si e pabazuar ankesa e paditurës, Kompania e Sigurimeve [“K...”], me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.Ek.nr.496/2018, të datës 02.09.2019, në pikën “I” dhe “III” të dispozitivit, **VËRTETOHET**.

**II.** Aktgjykimi i goditur në pikën “II” të dispozitivit, mbetet i pashqyrtuar.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses NNP [“A...”], me seli në fshatin ..., Komuna e Vitisë, ashtu që është detyruar e paditura Kompania e Sigurimeve [“K...”] me seli në Prishtinë që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material në kamion, rimorkio të kamionit dhe në eskavator t’ia paguaj shumën prej 11,741.00€, me kamatë ligjore në shkallën prej 8% në vit e cila fillon të rrjedh nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë dt.14.09.2018 e deri në pagesën definitive që të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi. Ndërsa në pikën II të dispozitivit është refuzuar pjesërisht si e pa bazuar kërkesëpadia e

paditëses NNP [“A...“], me seli në fshatin ..., Komuna e Vitisë e paraqitur kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve [“K...“] me seli në Prishtinë, në pjesën ku ka kërkuar që për shkak të dëmeve të shkaktuara në kamion, rimorkio dhe eksvatorë të detyrohet pala e paditur që t’ia paguaj shumën prej 6,500.00€ në emër të dëmit të formës të fitimit të humbur dhe atë për dëmtimin e rimorkios së kamionit dhe ekskavatorit , brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore. Dhe në piken III të dispozitivit është detyruar pala e paditur që palës paditëse t’ ia paguaj edhe shumën prej 9,46.80€ në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljeve të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoje ankesën e të paditurës si të bazuar, të prishet aktgjykimi IV.Ek.nr.496/2018, të datës 02.09.2019 dhe lënda i kthehet në rivendosje dhe rigjykim gjykatës së shkallës së parë, ose të ndryshohet aktgjykimi IV.Ek.nr.496/2018, të datës 02.09.2019 dhe kërkesëpadi mbi shumat e ofruara nga e paditura prej 5,761.00€ me kamatë ligjore siç e paguajnë bankat vendore për mjetet e afatizuara njëvjeçarë pa destinim të caktuar duke filluar nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Përgjigje ne ankese ka paraqitur pala e paditur, me propozim që Gjykata Apelit ne Prishtinë ankesën e të paditurës ta refuzoje si te pa bazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi IV.Ek.nr.496/2018, të datës 02.09.2019 te ndryshoje vetëm ne pjesën sa i përket pjesës refuzuese te miratoje dhe pjesën refuzuese duke aprovuar ne tërësi kërkesëpadinë ne tërësi pjesën tjetër të aktgjykimit të gjitha me kamat ligjore prej 8% sipas LMD-se nga ngritja e padisë dhe te detyroj te paditurën për pagesën e përgjigjes ne ankese sipas TOAK 320€ me taksat gjyqësore.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së , gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, NNP [“A...“], me seli në fshatin ..., Komuna e Vitisë, me datën 14.09.2018, pranë gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve [“K...“], me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit nga auto përgjegjësia. Ne padi ka theksuar se në aksidentin e trafikut të datës 02.10.2017 i cili ka ndodhur në fshatin ..., Komuna e Vitisë kanë qenë pjesëmarrës vetura “Damler” me numër të [targave ...], e cila në momentin e aksidentit posedonte policë sigurimi nga auto përgjegjësia të lëshuar nga pala e paditur dhe automjeti kamion i markës “Man 33” pronë e tij. Nga raporti Policisë dhe skicave të vendit të ngjarjes se shkaktari i aksidentit të ndodhur ka qenë drejtuesi i automjetit “Damler” i cili duke dashur që të kthehet në shiritin e tij për shkak të tejkalimit të pa sigurt e godet rimorkion e kamionit me ç’rast kamioni me

rimorkio dalin jashtë rrugës duke u aksidentuar. Gjithashtu ka pretenduar se si pasoje e aksidentit të ndodhur dëme të konsiderueshme materiale ka pësuar automjeti i tij transportues “Man 33” ne kamion dhe në rimorkio, po ashtu dëme të konsiderueshme ka pësuar edhe eskavatori i cili gjendej në rimorkio. Meqenëse automjet i Damler ka qenë i pajisur me police sigurimi nga auto përgjegjësia nga pala e paditur e paditura ka për detyrim kompensimin e dëmit të shkaktuar. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoje kërkesëpadinë dhe me aktgjykim ta detyroje palën e paditur që t’ia kompensoje dëmin material në rimorkio si dhe në eskavator si dhe t’ia kompensojë edhe dëmin në forme të fitimi të humbur në eskavator dhe në rimorkio. Paditësi pas nxjerrës se ekspertizës se makinerisë të datës 10.05.2019 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në shumën e përgjithshme prej 11,741.00€ në emër të kompensimit të dëmit material.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se ne mes palëve nuk ishte kontestuese fakti se më datën 05.10.2017, në fshatin ..., Komuna e Vitisë ka ndodhur aksident trafiku ku të përfshira në këtë aksident kanë qenë automjeti “Damler” me numër të [targave ...] dhe automjeti transportues kamion “Man 33” me numër të [targave ...], i cili ishte pronë i palës paditëse. Ishte jo kontestuese se në momentin e shkakimit të aksidentit automjeti i markës “Daimler” me numër të [targave ...], ishte i pajisur me policë sigurimi nga autopergjegjesia të lëshuar nga pala e paditur. Po ashtu nuk ishte kontestuese as fakti se deri të aksidenti ka ardhur me fajin e drejtuesin të automjetit “Damler”. Kontestuese në mes palëve ishte lartësia e kërkesëpadisë. Paditësi i është drejtuar në procedure të rregullt jashtë gjyqësorë palës së paditur për kompensimin e dëmit në kamion, rimorkio dhe eskavator. Pala e paditu në këtë procedure i ka ofruar shumën prej 2,161.00€ në emër të dëmit në kamion shumën prej 448,00€ në emër të kompensimit të dëmit në rimorkio dhe shumën prej 3,153.00€ në emër të dëmit të shkaktuar në eskavator në shumën e përgjithshme prej 5,761.00€ pala paditëse nuk e pranuar këtë shumë, ka pretenduar së dëmi është me i lartë. Për të përcaktuar vlerën reale të dëmit të shkaktuar në kamion, rimorkio dhe eskavator pronë e palës paditëse gjykata e shkallës së parë ka angazhuar ekspert nga lëmia e makinerisë. Eksperti i makinerisë [S.B] në raportin e tij të ekspertizës ka deklaruar se duke u mbështetur në procesverbalin mbi dëmin, dokumentacion e ofruar rezulton se si rezultat i aksidentit të ndodhur dëme material kanë pësuar tri mjete dhe atë kamioni, rikorkio e kamionit edhe eskavatori. Vlera e riparimit të këtyre mjeteve përfshirë në aksident përfshirë ngjyrosjen dhe TVSH-në është në shumën prej 11,741.00€.

Prandaj, mbi këtë bazë dhe duk u mbështetur në dispozitat e nenit 136 par.3, 169, 173.1,173.3 lidhur me nenin 382.1 të LMD-së, si dhe duke u mbështetur në dispozitën e nenit 452.par.1 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të

tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit ka gjetur se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht Nenet 136 par.1, 169 të LMD-së, kur ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit sepse me Nenet 136 të LMD-së përcaktohet se: *“se kush i shkakton dëm tjetrit ka për detyrë që ta kompensojë, në qoftë se nuk provohet se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*. Në rastin konkret nga raporti i aksidentit me numër ... rezulton se përgjegjës në aksidentin e datës 05.10.2017 ka qenë automjeti “Daimler” me numër të targave ..., i cili duke dashur që të kthehet në shiritin e tij, për shkak të tejkalimit të pa sigurte godet rimorkion e kamionit me ç ‘rast kamioni me rimorkio dalin jashtë rrugës duke u aksidentuar, me këtë rast si pasojë e aksidentit dëme të konsiderueshme material ka pësuar automjeti “Man 33” në kamion dhe në rimorkion, si dhe në eskavator, në këtë rast automjeti “Daimler” në momentin e aksidentit ka qenë i pajisur me policë sigurimi të detyrueshëm nga auto përgjegjësia të lëshuar nga pala e paditur, prandaj në këtë rast pala e paditur ka detyrim që palës paditëse t’ia kompensojë dëmin e shkaktuar në kamion, rimorkio të kamionit dhe në eskavator duke u bazuar edhe në nenin 3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia ku është përcaktuar se *“siguruesi është përgjegjës për kompensimin e dëmeve të shkaktuara personave të trete, nga përdorimi i automjetit të siguruar, mbi bazën e auto përgjegjësisë. Prandaj, kjo gjykate vlerëson së gjykata e shkallës së parë drejte ka vepruar kur ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadia e paditësit.*

Kjo gjykate vlerëson së gjykata e shkallës së parë drejta ka zbatuar edhe dispozitën e nenit 169 të LMD-së, në të cilin është përcaktuar se *“personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi. Kur rivendosja nuk është e mundur apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që ta bëjë këtë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t’ia paguaje dëmtuesit shumën përkatëse në të holla për efekt të kompensimit të dëmit. Prandaj, gjykata e shkallës së parë drejte ka vepruar kur vendimin e saj lidhur me lartësinë e dëmit material të pësuar paditësi në automjetin e tij e ka mbështetur në ekspertizën e makinerisë të punuar nga z. [S.B], dhe shuma e gjykuar në emër të riparimit të automjeteve të dëmtuara është përcaktuar duke pasur parasysh pjesët e dëmtuara të kamionit, rimorkios së kamionit dhe eskavatorit, duke e bërë krahasimin e tyre me procesverbalin e dëmit dhe faturën e riparimit, respektivisht me çmimin e pjesëve të cilat e aplikojnë serviset e autorizuara. Prandaj, ekziston obligimi i të paditurës për kompensimin e dëmit të shkaktuar në automjetin e paditësit në shumën e përgjithshme prej 11,741.00€.*

Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet ankimore të palës se paditur lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë përmes ekspertizës profesionale të mjaftueshme, e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse në arsyetimin e aktgjykimit, të cilën e pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa pretendimet e të paditurit janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të paditurit lidhur me lartësinë e shumës së kompensimit të aprovuar nga gjykata e shkallës së parë por gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka përcaktuar lartësinë e kompensimit duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe në ekspertizën e makinerisë nga eksperti gjyqësorë z. [S.B] të datës 10.05.2019.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivit i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Meqenëse aktgjykimi i goditur në pikën "II" të dispozitivit, nuk është goditur me ankesë, konform nenit 194 të LPK-së, mbetet i pashqyrtuar.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 nën pikën d) dhe e), të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,**  
**Ae.nr.337/2019 data 19.11.2020**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**  
**Mahir Tatuli, d.y.**

